**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
**INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**
**TIRANË**

**Rruga: "Aleksandër Moisiu", Nr 80, Tiranë, Albania.**
Tel: +355 4374756, Fax 355 43 70058

**Tiranë, 11/11/ 2009**

# BULETINI EPIDEMIOLOGJIK MBI QARKULLIMIN E GRIPIT TE RI PANDEMIK A(H1N1) NE SHQIPERI

Me poshte jepet nje pershkrim i gjendjes epidemiologjike dhe pasojave shendetesore lidhur me Gripin e ri pandemik A(H1N1) ne Shqiperi deri ne daten 10 Nentor 2009.

**Frekuenca e hasjes së "Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme" në javët 20 - 44 të vitit 2008 dhe të vitit 2009. Numri i rasteve. (perkatesisht deri me dt. 1. 11. 2009).**




- Kemi nje numer me te larte te infeksioneve respiratore krahasuar me nje vit me pare. Kete jave verejme nje trend ne rritje te numrit te infeksioneve respiratore krahasuar me javen paraardhese. Aktualisht jemi ne fazen e aktivitetit sezonal te pritshem.
- Numri me i madh i rasteve te infeksioneve respiratore verehet ne moshat feminore.
- Nuk kemi shperthim epidemik te infeksioneve te ngjashme me Gripin. Numri javor i rasteve eshte shume i ulet krahasuar me pragun epidemik

- Deri ne daten 10 Nentor 2009, jane marre 1037 mostra nga Tirana dhe rrethet. Numri me i madh i mostrave eshte marre ne grupmoshen 25 - 44 vjeç ku dhe vihet re dhe numri me i madh i rasteve te konfirmuara.

- Numri i pergjithshem i rasteve te konfirmuara me virusin A(H1N1) deri ne daten 10 Nentor 2009 eshte **54**. Per detaje shih grafiket bashkengjitur.

- Shenjat klinike te rasteve te konfirmuara gjate dy javeve te fundit kane qene mesatare dhe nuk jane shfaqur komplikacione. Survejanca ne te gjithe vendin eshte e perforcuar per zbulimin dhe monitorimin e rasteve me semundje te rende respiratore.

- Dje kane filluar te verehen grumbullime me raste infeksionesh respiratore ne disa shkolla ne Tirane dhe ne Mat. Ne njeren prej shkollave konfirmohet qarkullimi i gripit te ri A H1N1. Sot po kryhen hetimet e nevojshme epidemiologjike.

- Çdo dite ne ISHP perpunohen mostra te rasteve te dyshuara nga Tirana dhe rrethet e tjera te vendit

- Vec rritjes se vigjilences brenda sistemit shendetesor, Ministria e Shendetesise eshte ne kontakt te vazhdueshem me Ministrite e tjera me qellim uljen e qarkullimit te virusit ne mjediset e shkollave, vendet e punes, mjejet e transportit publik, repartet ushtarake, dhe institucionet sociale e kulturore.

## Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas grupmoshes




## Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas javes se raportimit



## Shperndarja e rasteve te konfirmuara sipas rretheve

